



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Prill 2017

Çfarë ka të Re në SHUKALB!

SHUKALB Mbështet Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime Shqiptare në Festimin e Ditës Botërore të Ujit



Çdo vit, Dita Botërore e Ujit nxjerr në pah një aspekt specifik të ujit dhe është një mundësi unike për të tërhequr vëmendjen dhe për të krijuar mundësinë për të

nxitit qeverinë, shoqërinë civile dhe individët të ndërmarrin iniciativa të tilla ndërgjegjësimi. Në Ditën Botërore të Ujit të Kombeve të Bashkuara të këtij viti, e cila sjell në fokus çështjen e ujit të ndotur, Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë shfrytëzon këtë mundësi për të tërhequr vëmendjen tek nevoja për investime kapitale dhe operacionale domethënëse në sigurimin e shërbimeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujit të ndotur në Shqipëri, shërbime këto që garantojnë mbrojtjen e shëndetit publik, si dhe mjedisin. [lexo më shumë](#)

Programi i Trajnimit të SHUKALB, 2017

Kurset e Trajnimit të Dhëna në Mars

Gjatë muajit mars, SHUKALB dha me sukses dy kurse të tjera trajnimi, “Cilësia e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes” dhe “Udhëzues për Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime”. Kursi i parë i trajnimit



Kalendari i Përbashkët
i Trajnimeve
SHUKALB-SHUKOS
2017



Kurset e Ardhshme
të Trajnimit!

[Kontrolli i Rrjedhjeve](#)

- 21 Prill

[Mbikqyrja](#) - 27-28 Prill

Eventet e
Ardhshme!

Konferenca “Shqipëri –
Hungari: Sjellim së
Bashku Profesionistët e
Biznesit dhe Ujit”

Bashkohuni me Ne!



“Cilësia e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes“, u dha më 16-17 mars, në Hotel Mondial, Tiranë, nga lektorët Tania Floqi, Lektore në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit

dhe Astrit Menalla, Expert në Furnizimin me Ujë, dhe u ndoq nga pjesëmarrës nga shoqëritë ujësjellës kanalizime Shkodër, Vlorë, Prizren dhe Gjiilan.[lexo më shumë](#)

Kurset e Trajnimit që do të Zhvillohen në Prill



SHUKALB ka planifikuar dhënien e dy kurseve të trajnimit gjatë muajit Prill 2017, “Kontrolli i Rrjedhjeve” dhe “Mbikqyrja”.Kursi i trajnimit “Kontrolli i

Rrjedhjeve” do të jepet më 21 Prill, në Tiranë. Gjatë këtij kursi trajnimi pjesëmarrësit do të marrin njohuritë bazë të nevojshme mbi zhvillimin e strategjive të menaxhimit të rrjedhjeve dhe lokalizimin e tyre, si dhe të shpjegojnë teknikat e menaxhimit të presionit dhe mënyrën e projektimit të Zonave të Matura të Shërbimit (DMA).[lexo më shumë](#)

Lajme nga Anëtarët tanë

Projekti i Ri i Tunelit në Mailin e Dajtit Rrit Furnizimin me Ujë dhe Redukton Kostot



Një nga projektet më të mëdha që aktualisht është duke u ndërtuar nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë është fokusuar në shfrytëzimin më të mirë të burimeve të

ujësjellësit të Shën Mërisë, i cili do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme sasinë e furnizimit me ujë për qytetarët e Tiranës, kursen energji duke e transportuar këtë burim përmes vetërrjedhjes, si dhe duke ushqyer hidrocentralin e Lana Bregasit, duke rritur kështu sasinë e energjisë së prodhuar. Ky investim është një prej projekteve strategjike që



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

do t'i shërbejë në të ardhmen nevojave të zonës së shërbimit të Tiranës, në mënyrë që t'i paraprihet rritjes së pritshme të popullsisë dhe shtimit të cilësisë së shërbimit të kërkuar nga qytetarët.[lexo më shumë](#)

Intervistë me Z. Denis Hallulli, Përgjegjës Teknik, UK Elbasan



Në Burimin e muajit mars, SHUKALB publikoi një interviste me një inxiniere të re e cila çdo ditë udhëtonte nga Tirana në Shkodër dhe anasjelltas për të qenë pranë vendit të punës.

Intervista që kemi këtë muaj

flet sërish për një inxiniere të ri, i cili vjen nga Tirana dhe ka zgjedhur të punojë në qytetin e Elbasanit. Ai është Z. Denis Hallulli, Përgjegjës Teknik pranë Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan. Denisi ka mbaruar studimet e larta pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në degën Mjedis Trajtim Uji, i diplomuar në vitin 2010 në Master Shkencor. Pas përfundimit të studimeve të larta është punësuar pranë Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, ku ka punuar për një periudhë 6 vjeçare si Inxiniere në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe në sektorin e shitjes. Nga muaji Shtator 2016 e në vazhdim, ai punon pranë Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan në pozicionin e Përgjegjësit Teknik.[lexo më shumë](#)

Konferenca “Shqipëri – Hungari: Sjellim së Bashku Profesionistët e Biznesit dhe Ujit”



mbasada Hungareze, Shoqata Hungareze e Ujësjetllësve, Ujësjetllësi i Budapestit, në bashkëpunim me Shoqatën Ujësjetllës Kanalizime të Shqipërisë

(SHUKALB), organizojnë Konferencën me titull “Shqipëri – Hungari: Sjellim së Bashku Profesionistët e Biznesit dhe Ujit”, e cila do të mbahet në Hotel Plaza, Salla Mbretëresha Geraldinë, Tiranë më 10 Prill, 2017, ora 9:00 paradite. Qëllimi kryesor i Konferencës së Profesionistëve të Ujit Shqipëri –

Hungari është të ofrojë një platformë efektive për diskutim, forcimin e bashkëpunimit dhe transferimin e njohurive ndërmjet profesionistëve të biznesit dhe ujit të të dyja vendeve. [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

Edicioni i 20-të i Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike | Torino, Itali | 4-15 shtator 2017



Shkolla e Rregulloreve Lokale të Torinos njofton se ka hapur zyrtarisht aplikimet për Edicionin e 20-të të **Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren**

e Shërbimeve Publike. Shkolla Verore u drejtohet studentëve të vitit të fundit, studentëve të diplomuar dhe zyrtarëve të Administratës Publike (bashkive, prefektuarave, organeve rajonale) dhe agjencive rregullatore.

Pjesëmarrësit që do të përzgjidhen do të mund të përfitojnë nga tarifat shumë të ulëta të regjistrimit; **regjistrim falas** për vendet jo anëtare të OBEZH (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) siç është Shqipëria dhe shteteve të anëtarësuaras rishitaz në BE.

Regjistrimi përfshin **2 javë akomodim falas** në Torino.

Aplikimet janë të hapura. Afati: **5 qershor 2017.**

Për informacion të mëtejshëm dhe formën e aplikimit ndiqni linkun: www.turinschool.eu/iss

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi
Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al